

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VITIN 2006

Pasi u njoh me Raportin Vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2006, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kuvendi,

- duke njohur rolin e KKRT-së, si enti i vetëm rregullator në fushën e transmetimeve radio e televizive dhe autoriteti kryesor i zbatimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë;

- duke vlerësuar se veprimtaria e KKRT-së është në vazhdim të përpjekjeve të zbatimit të reformave institucionale për përshtatjen e saj me të gjitha funksionet ligjore në fushën e transmetimeve radio e televizive;

- duke qenë i ndërgjegjshëm se veprimtaria e KKRT-së është zhvilluar në kushtet e ekzistencës së shumë operatorëve në treg dhe të një situatë, ku zhvillimet teknologjike në fushën e transmetimeve radio e televizive kanë qenë të vrullshme;

- duke çmuar si jashtëzakonisht të rëndësishëm bashkëpunimin ndërinstitucional të KKRT-së me institucionet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, si Këshilli i Europës, OSBE-ja etj.;

Konstaton se:

- KKRT-ja ka bërë hapa pozitivë në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- janë bërë hapa përpara në drejtim të rregullimit të veprimtarive të transmetimeve radio e televizive në Republikën e Shqipërisë;

- KKRT-ja, megjithëse e vonuar, ka ndërmarrë hapa në drejtim të zbatimit të kërkesave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- KKRT-ja nuk ka qenë në gjendje të ndalojë në kohë operatorët, të cilët kanë shkelur kushtet e parashikuara në licencat e tyre, lidhur me hapësirat e transmetimeve radio e televizive;

- KKRT-ja nuk ka zbatuar në mënyrë rigoroze dhe të padiferencuar kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- KKRT-ja është gjetur e papërgatitur në hartimin në kohë të planit kombëtar të caktimit të frekuencave për transmetimet analoge tokësore dhe ato numerike, në përputhje edhe me parashikimet e Konferencës së Radiokomunikacioneve RRC-04 Gjenevë, maj 2004 dhe të Marrëveshjes së Gjenevës GE06.

Duke njohur rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm dhe të përmirësimit të legjislacionit në fushën e veprimtarive të transmetimeve radio e televizive, si dhe rolin përcaktues të KKRT-së në këtë fushë,

Kuvendi i kërkon KKRT-së:

- i tërheq vëmendjen KKRT-së në drejtim të rritjes së autoritetit të zbatimit të ligjit në mënyrë konstante dhe pa diferencime nga ana e këtij institucioni;

- hartimin në një kohë sa më të shkurtër të Planit Kombëtar të Caktimit të Frekuencave në fushën e transmetimeve analoge dhe numerike;

- reformimin e mëtejshëm ligjor e institucional të KKRT-së, për ta organizuar atë në mënyrë më funksionale dhe sipas të njëjtave parime që organizohen autoritetet rregullatore në të gjitha vendet europiane.

4 qershor 2007